



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 2062 Prot.

Lezhë, më 12 / 02 / 2026

URDHËR

Nr. 114 Dt. 12. 02 .2026

**PËR
“NGRITJEN E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E
STREHIMIT”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.06.2023, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr. 454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese, VKM nr. 405 datë 01.06.2016 për “Miratimin e Strategjisë për Strehimin Social” si dhe Urdhëri nr.12, datë 09.01.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 03, datë 06.01.2025 “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2026.

URDHËROJ :

1. Të ngrihet struktura përgjegjëse për menaxhimin e programeve sociale të strehimit.
 2. Struktura përgjegjëse do të përbëhet nga përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social si:
 - Drejtor;
 - Përgjegjës;
 - 2 specialist për strehimin social.
 3. Struktura e ngritur në pikën 2 të këtij Urdhëri do të identifikojë individët/familjet në nevojë për strehim, zbatojë programet e strehimit social në nivel vendor si dhe të kryejë vlerësimin dhe verifikimin e individëve/familjeve në nevojë për strehim.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Pjerin Ndreu**

